V E N D I M
Nr.52, datë 01.02.1991

PËR DOGANAT

Më propozim të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Organet doganore ndalojnë futjen në territorin e vendit tonë të këtyre sendeve e mallrave:

a) Armët e të gjitha llojeve dhe municionet e tyre, duke përjashtuar armët e gjahut e municionet e tyre.

b) Lëndët plasëse, djegëse, helmuese, radioaktive dhe të gjitha llojet e eksplozivëve.

c) Substancat toksike, narkotike e psikotrope.

ç) Materialet propagandistike me përmbajtje armiqësore ndaj shtetit tonë, si dhe ato me akte pornografike.

d) Mallrat që me dispozita të veçanta janë monopol i shtetit.

Sendet dhe mallrat e mësipërme mund të futen për interesa shtetërorë vetëm me autorizim të ministrisë ose institucionit tjetër qendror, që i ka objekt kryesor të veprimtarisë.

2. Organet doganore ndalojnë nxjerrjen nga territori i vendit tonë të këtyre sendeve e mallrave:

a) Metalet dhe sendet e tjera të çmuara.

b) Valutat, letrat me vlerë, llojet e ndryshme të monedhave, pullat postare, si dhe sende të tjera me vlerë të kësaj natyre.Përjashtim bëhet për personat fizikë që nxjerrin jashtë shtetit valutë për nevojat e tyre sipas rregullave që caktohen nga Ministria e Financave.

c) Objektet antike me vlera artistike e arkiologjike, si dhe objektet e kultit e të tjera të ngjashme me to.

ç) Veshjet karakteristike me vlera folklorike e artistike.

d) Dokumentet, dorëshkrimet dhe librat me vlerë, si dhe të gjitha botimet që përbëjnë pasuri kulturore kombëtare.

dh) Veprat e artit të vjetra e të reja, kombëtare e të huaja, të cilat përbëjnë pasuri kulturore kombëtare.

e) Mallrat e sendet që përcaktohen në shkronjat "a", "b", "c", e "d" të pikës 1 të këtij vendimi.

Sendet dhe mallrat e mësipërme mund të nxirren, për interesa shtetërorë vetëm me autorizim të ministrisë ose institucionit tjetër qendror, që e ka objekt kryesor të veprimtarisë.

Mallrat dhe sendet e caktuara në shkronjat "d" e "dh" mund të nxirren nga personat fizikë vetëm me autorizim të organit përkatës kompetent.

3. Organet doganore kontrollojnë, vërtetojnë e lejojnë kalimin tranzit të mallrave dhe mjeteve nëpër territorin e vendit tonë, kur ato janë pajisur me leje të lëshuara nga Ministria e Transporteve në bazë të rregullave ndërkombëtare.

4. Mallrat (pakot) që vijnë ose dërgohen nëpërmjet dërgesave postare e kolipostare ndërkombëtare, i nënshtrohen kontrollit doganor në mjediset e organve postare, në prani të personave marrës ose dërgues të tyre.

5. Për mallrat (pakot) që vijnë nëpërmjet postës dhe për ato që u vijnë personave në rrugë ujore, ajrore, hekurudhore e tokësore, zbatohen tarifa doganore të diferencuara sipas peshës, të caktuara nga Ministria e Financave.

6. Gjithë personat fizikë që kalojnë kufirin shtetëror të vendit tonë, i nënshtrohen kontrollit doganor. Organet doganore kanë të drejtë të ushtrojnë ndaj tyre edhe kontroll fizik.

7. Personat fizikë që vijnë nga jashtë shtetit, nuk i nënshtrohen taksave doganore për

mallrat dhe sendet që janë për nevoja vetjake dhe familjare.

8. Kur organet doganore vërejnë se mallrat ose sendet e sjella ose të dërguara nga jashtë shtetit nga personat fizikë, janë për qëllime tregtie ose shërbimesh private, zbatohen taksat doganore si vijon:

-Për artikujt ushqimorë, 10 për qind mbi çmimin e shtijes me pakicë.

-Për artikujt industrialë ,20 për qind mbi çmimin e shtijes me pakicë.

-Për tekstile e konfeksione,15 për qind mbi çmimin e shtijes me pakicë.

9. Për makineri dhe pajisjet që shërbejnë për qëllime tregtie ose shërbimesh private si dhe motorçikletat e automjetet, që sillen ose dërgohen nga jashtë shtetit, zbatohen këto taksa doganore:

- Për makineritë e pajisjet e reja 30 për qind të çmimit të blerjes me valutë, të konvertuara me lekë me kursin ekonomik në fuqi. Kur ato janë të përdorura, 20 për qind të çmimit të shtijes me pakicë.

- Për automjetet dhe motorçikletat e reja 20 për qind të çmimit të blerjes me valutë, të konvertuara me lekë me kursin ekonomik në fuqi.

-Për automjetet e përdorura taksat doganore të jenë sipas listës që bashkëlidhet këtij vendimi.

- Për motorçikletat që kanë përshkruar mbi 5 mijë km, zbatohet taksë doganore në masën 1 000 lekë.

10. Mjetet e transportit të personave që hyjnë përkohësisht në vendin tonë, lejohet të kalojnë në bazë të deklarimit të bërë në doganë dhe të vërtetimit të lëshuar prej saj, me kusht që këta persona t'i marrin me vete në kthim.

Kur personat këto mjete nuk i marrin me vete në kthim e nuk paguajnë taksën doganore, mbajtësit e tyre paguajnë dyfishin e taksës doganore të caktuar në pikën 9 të këtij vendimi.

11. Personat që dalin jashtë shtetit, lejohen të marrin me vete sende ushqimore, pije alkolike dhe cigare për nevoja të përdorimit vetjak në masën e caktuar nga Ministria e Financave.

12. Mallrat dhe sendet që për arsye të ndryshme mbeten në doganë, ose kur për to nuk paguhet taksa doganore, shiten me çmimet e shitjes me pakicë të vendit tonë. Kur ato janë të përdoura, u bëhen zbritje çmimesh sipas amortizimit.

Kur ato nuk kanë vlerë përdorimi, asgjesohen me komision të caktuar nga Drejtori i doganave dhe, kur kanë vlerë përdorimi e mund të shrytëzohen, i shiten ndërmarrjeve ose institucioneve.

Çmimet e shtijes në të gjitha rastet vendosen sipas rregullave nga një komision i caktuar nga Drejtori i Doganave.

13. Ngarkohet Ministria e Finacave të nxjerrë rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij vendimi.

14. Për mallrat që në kohën e daljes së këtij vendimi ndodhen në doganë dhe kur nuk janë tërhequr nga personat e interesuar, zbatohen kriteret e caktuara në këtë vendim.

15. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.57, datë 6.2.1989 "Për kontrollin dhe tagrin doganor", vendimi i Këshillit të Ministrave "Sekret" nr.7, datë 24.1.1990 "Për disa kritere për sjelljen nga jashtë shtetit të literaturës së huaj, kasetave, videokasetave e materialeve të tjera", vendimi i Këshillit të Ministrave "Sekret" nr.405, datë 24.10.1987 "Për përjashtimet nga kontrolli dhe tagri doganor", si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave "Sekret" nr.58, datë 6.2.1989 "Për një ndryshim në vendimi e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 24.10.1987 "Për përjashtimet nga kontrolli dhe tagri doganor", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI

TAKSAT DOGANORE PËR AUTMJETET E PËRDORURA

1.Për autoveturat

a) Mbi 10 mijë km deri në 100 mijë km 15 mijë lekë
b) Mbi 100 mijë km 10 mijë lekë

2. Për mikrobusët, kamionçinat dhe kamionë deri në 3 tonë

a) Mbi 10 mijë km deri në 150 mijë km 30 mijë lekë
b) Mbi 150 mijë km 20 mijë lekë

3. Për kamionët mbi 3-tonësh dhe autobusët

a) Mbi 10 mijë km deri në 200 mijë km 50 mijë lekë
b) Mbi 200 mijë km 30 mijë lekë